



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA		
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO		
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL		
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA		
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT		
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive		
Nr./Br./No.	3304	
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	3	
Data/Datum/Date	10.08.2023	
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA		

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Datë: 08.08.2023  
Ref. KM-267/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**VENDIM**

**Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim**

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Follow 80 WG i prodhuesit “Sharda Cropchem Limited”, Indi nga përfaqësuesi i saj NTP“Jonatan-P” Prizren.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Fungicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Folpet.....842.1g/kg

**4. PËRDORIMI:**

Në **hardhi**, për kontrollin e vrugut (Plasmopara viticola), kalbezimit gri (Botrytis cinerea), kalbezimit te zi (Guignardia bidwelli), kancerit te hardhise (Phomosis spp)., njollosjes se kuqe te gjetheve (Pseudopeziza tracheiphila). Përdorimi ne fillim te lulezimit ndikon shume mire per lidhjen e frutave (pllenimin) si dhe per nje zhvillim te mire vegjetativ.

Perdoret me 1.25 kg preparat/ha i perzier me 12.6 kg/ha sqfukur, te tretur ne 1000 lit uje, ose me 125 gr preparat/100 lit ujë. Kryhen deri 4 trajtime/sezoni me interval 7-10 dite. Kur perdoret i vetem doza eshte 1.5-1.8 kg preparat/ha, te tretur ne 1000 lit uje, ose me 150-180 gr preparat/100 lit ujë.

**Ne pemet frutore:** kunder kromave (*Venturia inequalis* & *V.pirina*), alternaries (*Alternaria* sp), kalbezimit te zi (*Glomerella cingulata*), gjetheperdedheses (*Taphrina deformans*), antraknozave (*Gleospodium fructigenum*), ndryshkut (*Tranzshelia discolor*) etj. Perdoret me 3-3.75 kg preparat/ha, te tretur ne 2000-3000 lit uje, ose me 150 gr preparat/100 lit ujë. Kryhen deri 6 trajtime/sezon me interval 7-10 dite.

- **Ne patate, perime (domate, kungullore), luleshtrydhe dhe bime zbukuruese,** për kontrollin e vrugjeve të familjes Peronosporaceae, si dhe të sëmundjeve të tjera si: kalbëzimet (*Botrytis* spp.), antraknozot, *Cladospora*, *Colletotrichum*, *Septoria* spp., *alternaria* (*Alternaria* spp.) në domate, kungullore, etj. Perdoret me 2.5 kg preparat/ha, te tretur ne 2000 lit uje, ose me 125 gr preparat/100 lit ujë. Kryhen deri 6 trajtime/sezon me interval 7-10 dite.

- **Ne ulli,** per kontrollin e *Spilocaea oleagina*. Perdoret me 3 kg preparat/ha, te tretur ne 2000 lit uje, ose me 150 gr preparat/100 lit ujë. Kryhen deri 6 trajtime/sezon me interval 7-10 dite. Kryhen deri 4 trajtime/sezon me interval 7-10 dite.

#### 5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

50g,100g,250g,300g,500g,1kg,2kg,5kg,10kg

#### 6.VËREJTJE:

Tek rrushi për verë të ndërpriten trajtimet 28 ditë para vjeljes, për të mos penguar fermentimin e mushtit.

Fitotoksiciteti: Tek rrushi i tavolinës, para se të bëhet përzierje me preparate të tjera, të verifikohet selektiviteti në bimë të kufizuara. Spërkatjet me vajra minarale nuk duhet të kryhen pa kaluar 30 ditë nga trajtimi me folpet.

#### 7. KARENCA:

7 ditë për domaten; 10 ditë për rrushin e tavolinës dhe luleshtrydhen; 21 ditë për kungulloret; 40 ditë për rrushin për verë; 120 dite per ullirin.

#### 8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3).



GHS08-i dëmshëm për shëndetin



GHS09- paralajmerim (cat 1)-i rrezikshëm për ambient.

**9. VENDI I SHITJËS:** Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

**10.** Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

**11.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



*Vendimi i dërgohet:*

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*